



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Janar 2021

Nr: 7

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT PËR SHKELJE TË
PARASHIKUAR NË VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË KOMISIONIT
RREGULLATOR NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE NDAJ
Z. ARBEN QALLIU

Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VËREJ:

I

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me datë 30.12.2020 janë raportuar dy denoncime nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, për veprimtaritë e deputetit të Partisë Socialiste, Qarku Fier, z. Bujar Çela, i cili ka publikuar në llogarinë e tij personale në Facebook disa foto me qytetarë të ndryshëm duke shpërndarë leje legalizimi të shtëpive të tyre në Njësinë Administrative Hysgjokaj. Denoncimet janë regjistruar nga ndërfaqja në datë 30 dhjetor 2020 ora 19:18 dhe ora 19:39.

Sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tyre.

Neni 3, paragrafi 2 i Vendimit Nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror; agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare



dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

Duke qenë se denoncimi i subjekti politik (LSI) të orës 19:18 të datës 30 dhjetor 2020 lidhet vetëm me deputetin z. Bujar Çela, theksojmë se deputeti nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 3 të vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi. Sa më sipër, i është njoftuar denoncuesit në rrugë elektronike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vijoi procedurën e administrative për shqyrtimin e denoncimit të paraqitur nga ana e subjektit politik Lëvizja Socialiste në ndërfaqen e KQZ në orën 19:39.

Sipas këtij denoncimi të raportuar më datë 28.12.2020 ora 19:39 deputeti i Partisë Socialiste, Bujar Çela ka postuar në faqen e tij të Facebook-ut disa foto me qytetarë të ndryshëm duke shpërndarë leje legalizimi të shtëpive të tyre me mbishkrimin *"Këto ditë të fund vitit po i shfrytëzojmë në maksimum për të sjellë sado pak gëzim në këto familje punëtore, që një pjesë të konsiderueshme të kursimeve të tyre i kanë hedhur në këto banesa. Sot isha në Njësinë Administrative Hysgjokaj ku preka nga afër punën e tyre të materializuar në kapital. PUNA VAZHDON. Punë -Vizion -Durim"*.

Sipas denoncuesit *"Kjo veprimtari e tij bie ndesh me nenin 3, pika 1.3, germa "a", e vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili parashikon si veprimtari të ndaluar shpërndarjen në veprimtari publike lejet e legalizimit për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Kjo veprimtari e tij në mënyrë të përsëritur ka implikuar edhe Drejtorinë Rajonale të Kadastrës në qytetin e Lushnjës, e cila ka detyrë funksionale shpërndarjen e këtyre dokumenteve. Këto lloj dokumentesh nuk mund të gjenden në duart e deputetit të qarkut e aq më tepër të shpërndahen prej tij."*



Sa më sipër denoncuesi kërkon shqyrtimin e rastit konkret dhe marrjen e masave sipas parashikimeve të vendimit të mësipërm.

II

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi denoncimin, në verifikimin paraprak të të dhënave, konstatoi se:

Neni 91 pika 1 e Kodit Zgjedhor përcakton se:

“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor; apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”

Neni 92 i Kodit Zgjedhor përcakton se:

“Neni 92

Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë

1. *Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.*

2. *Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrative të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.*

3. *Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar te kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.*

4. *Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron*



ndalimin e zhvillimit të saj. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë. Shënimi “Ndaluar nga KQZ-ja” vendoset jo më vonë se dy ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga publiku, nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

5. Veprimtaritë e ndaluara nga KQZ-ja nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me këtë pikë ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji transmetuesin radioteleviziv.

6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.

7. Rregullat për shqyrtimin, kryesisht ose me kërkesë, të rasteve që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 4 të këtij neni, miratohen nga KQZ-ja me akt normative”.

Referuar nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, shkronja “a” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “veprimtari të ndaluara janë edhe ato veprimtari që përfshijnë shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”.

Referuar nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, shkronja “b” të vendimit të sipërcituar ndalohet shpërndarja në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, çertifikatave të pronësisë, dhe çfarëdoqë titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën” në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Referuar nenit 3 paragrafi 2 i vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përcaktohen rrethi i subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi si më poshtë vijon:

“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione



e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.

III

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me date 11.01.2020 ora 12:00, në përputhje me përcaktimet e nenit 47 dhe 87 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” ka zhvilluar një seancë dëgjimore me z. Arben Qalliu.

Komisioneri bazuar në nenin 80 të “Kodit të procedurave Administrative” i kërkoi z Arben Qalliu të japë shpjegime lidhur me këto pyetje:

1. Drejtoria Vendore e ASHK-së Lushnjë ka në juridiksionin e saj dhënien e certifikatave të pronësisë/ leje legalizimi për Njësinë Administrative Hysgjokaj?
2. Në muajin dhjetor 2020 dhe në periudhën e denoncimit të faktit sa certifikatave të pronësisë/ leje legalizimi janë lëshuar nga kjo Drejtori Vendore?
3. Certifikatat e pronësisë/ lejet e legalizimeve përgjatë kësaj periudhe kur janë dhënë dhe në çfarë mënyrë u janë dorëzuar aplikantëve (E-Albania, sportel, dorazi)?
4. A keni dijeni që stafi juaj të ketë shpërndarë certifikata në kundërshtim me vendimin nr. 9/ 2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve të ndaluara ?

Në shpjegimet e tij z. Qalliu konfirmoi se Njësia Administrative Hysgjokaj është në juridiksionin e strukturës vendore të ASHK Lushnjë për dhënien e certifikatave/ leje legalizimeve.

Z. Qalliu sqaroi se nga data 1 deri në datën 20 të çdo muaji stafi i ASHK punon në lidhje me procedurën e përpunimit të dosjeve dhe pas datës 20 të çdo muaji deri në datën 30, që është 10- ditëshi i fundit ata bëjnë emërtimin ose printimin e lejeve të legalizimit.

Sipas tij vetëm në 10-ditëshin e fundit administrata e ASHK-se Lushnjë ka të drejtën ligjore të printojë leje, pasi dhe sistemi hapet në atë 10-ditësh nga zyra qendrore.

Për periudhën Nëntor, janë printuar afro 130 leje legalizimi për dy bashki, për Bashkinë Lushnje dhe Bashkinë Divjakë dhe janë shpërndarë jo me shume se 40% e tyre.

Ai sqaroi se lejet e legalizimit printohen ne 3 kopje të njëjtlshme, një leje në karton të cilën e merr qytetari, një leje që mbahet në dosjen e lejes së legalizimit, dhe një leje që është dublikatë me të cilën vazhdon procesi i regjistrimit në sektorin e hipotekës.



Sipas tij “kam një muaj e pak që kam mbyllur dhe pritjen e qytetarëve, pasi në ASHK-në Lushnje nga fundi i muajit Shtator deri sot që flasim ne kemi përditë raste pozitive të punonjësve dhe për të mos e krijuar më të vështirë procesin, qoftë me punonjësit qoftë me qytetarët e kam mbyllur sportelin pranë ASHK-së sime dhe komunikimin me qytetarin e kam ose virtual me telefon ose me anën e grupeve të terrenit që kam.”

Në lidhje me mënyrat e dorëzimit të certifikatave ai sqaroi se janë dy forma njëra në sportel dhe tjetra fizikisht. Ai sqaroi se procesi i lëshimit të certifikatave të pronësisë dhe leje legalizimeve janë të ndryshme.

Certifikatat e pronësisë në ndryshim nga leja e legalizimit kanë një veçanti tjetër që qytetari e merr drejtpërdrejtë në E-Albania, ndërsa për lejet e legalizimit ka shumë interes që specialisti im, pasi ta ketë dorëzuar ta sqarojë se çfarë duhet të bëjë në hapat në vazhdim.

Pyetjes se si këto certifikata kanë përfunduar në dorën e deputetit, z. Qalliu shpjegoi se nuk i ka dhënë personalisht apo institucioni që ai administron deputetit leje legalizimi për të bërë shpërndarjen e tyre.

Duke qene se ndarja e leje legalizimeve behet në bazë të zonave kadastrale për një muaj të tërë ai ka nxjerrë urdhër të brendshëm për të nxjerrë grupet e terrenit që bëjnë dhe matjet, duke i ngarkuar edhe detyrën e dorëzimit të lejeve të legalizimit me procesverbal, si dhe informimin e qytetarëve që pasi ka marrë lejen të aplikojnë në ADISA për të marrë certifikatën. Sipas tij punonjësit e tij kanë marrë firmën e qytetarit dhe kjo kupton se ata kanë vajtur në terren nëpër familje për të bërë matje.

Në kuadër të kësaj procedure z. Arben Qalliu ka dorëzuar si prova:

1. Urdhri nr. 3066, datë 9.12.2020 i Drejtorit të Drejtorisë Vendore Lushnje, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
2. Procesverbal nr. 13688/2 prot. datë 09.12.2020 për shpërndarjen e leje të legalizimeve në njësinë administrative Hysgjokaj për 8 individë.
3. Procesverbal nr. 13688/1 prot. datë 09.12.2020 për shpërndarjen e leje të legalizimeve në njësinë administrative Golem për 15 individë.
4. Procesverbal nr. 13688/3 prot. datë 09.12.2020 për shpërndarjen e leje të legalizimeve në njësinë administrative Karbunarë e Vogël për 8 individë.
5. Leje legalizimi shoqëruar me vendim për kualifikimin e ndërtimit informal dhe Gen Plan për 8 banorë të njësisë administrative Hysgjokaj



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi të pranojë aktet e mësipërme si provë dhe ju bë me dije se do të njoftohet në lidhje me vendimin përfundimtar pas vlerësimit të provave të paraqitura prej tij.

Më datë 13 janar 2021 z. Arben Qalliu është njoftuar nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në rrugë elektronike dhe me telefon se njoftimi i vendimit përfundimtar do të bëhet më datë 14 janar 2021 ora 13:00.

IV

Në përputhje me parashikimet e nenit 81 të Kodit të Procedurës Administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga z. Arben Qalliu, çmon sipas bindjes së tij, se dokumentet e pranuar si prova të cituara më sipër, nuk janë të mjaftueshme për të provuar mungesën e përgjegjësisë së tij në shpërndarjen e lejeve të legalizimit nga ana e deputetit z. Bujar Çela në një veprimtari publike të ndaluar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se veprimtaria e zhvilluar nga deputeti z. Bujar Çela, shpërndarja e lejeve të legalizimit, në veprimtari publike përbën shkelje të parashikimeve të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, germa “a” të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020.

Jemi përpara faktit që një deputet ka shpërndarë leje legalizimi, pra një dokument administrativ në kompetencë të ASHK Lushnjë, dokumente të cilat nuk prodhohen nga vetë ai. Lejet e legalizimit të shpërndara nga deputeti janë dokumente të prodhuara dhe në zotërimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnje, nën juridiksionin e së cilës është edhe njësia administrative Hysgjokaj.

Në parashikim të nenit 10, paragrafi 5, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, **Drejtori i drejtorisë vendore është autoriteti që lëshon akte kadastrale për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial të drejtorisë dhe nxjerr aktet në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë”.**

Në këtë rast, duke qenë se lëshimi i akteve kadastrale është në kompetencë të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Drejtorisë Vendore, përgjegjësia për shpërndarjen e këtij dokumentacioni në veprimtari publike në Njësinë Administrative Hysgjokaj, pjesë përbërëse e Bashkisë Lushnje, i ngarkohet Drejtorit të Drejtorisë Vendore A.SH.K Lushnjë, Z. Arben Qalliu, i cili me veprime apo mosveprime ka kontribuar në zhvillimin e këtij aktiviteti.



Z. Arben Qalliu me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore ASHK Lushnjë ka nxjerrë me datë 09.12.2020, Urdhrin Nr. 3066 prot. për të shpërndarë në terren lejet e legalizimeve.

Neni 91 i Kodit Zgjedhor përcakton se nuk mund të përdoren ose **të vihen në mbështetje** të kandidatëve, **të partive politike** ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj entit tjetër, ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

Në zbatim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, vendimi nr. 9/2020 i miratuar nga Komisioni Rregullator në KQZ, ka sanksionuar ndalimin e subjekteve të përcaktuara (neni 3, paragrafi 2 i vendimit 9/2020 të KQZ) që të drejtojnë të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme në veprimtari të ndaluara.

Z. Arben Qalliu nuk paraqiti asnjë provë për të dëshmuar se veprimtaria e tij si Drejtues i Drejtorisë vendore ASHK Lushnjë garanton respektimin e dispozitës ligjore të sipërcituar.

Procesverbalet e dorëzimit të leje legalizimeve për njësinë administrative Hysgjokaj, që mbanin datën 9 dhjetor 2020, dëshmonin dorëzimin e 8 leje legalizimeve në këtë njësi, leje legalizimi të cilat ishin miratuar në muajin nëntor 2020, në një kohe që aktivitetet e ndaluara të raportuara janë të datës 28 dhjetor 2020.

Procesverbalet e dorëzuara nga ASHK Lushnjë përbënin rreth 24% të certifikatave të shpërndara nga totali i printuar në muajin nëntor 2020, ndërkohë që nuk jepej asnjë informacion për periudhën kur është kryer aktiviteti.

Në shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore z. Qalliu deklaroi se:

“Ndërsa certifikatat e pronësisë në ndryshim nga leja e legalizimit kanë një veçanti tjetër që qytetari të vijë te ne apo të vijmë ne te ai, pasi te E-Albania e vet, te dokumentet e mia i vjen e vetmja mënyrë e firmosur e certifikatës së pronësisë. Prandaj lejen e legalizimit ka shumë interes që specialisti im, pasi ta ketë dorëzuar ta sqarojë se çfarë duhet të bëjë në hapat në vazhdim, ndërsa certifikata e pronësisë është shumë e thjeshtë, mjafton që ai të bëjë një aplikim te E-Albania dhe certifikata i dorëzohet në rrugë elektronike te adresa e qytetarit dhe ai e konfirmon nga telefoni i vet dhe nuk ka nevojë fare të vijë tek ne”

Këto thënie të tij nuk gjejnë mbështetje në vendimin nr. 954, datë 25.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit”, vendim në fuqi në kohën e kur është nxjerrë urdhri nr. 3066, datë 9.12.2020 i Drejtorit Arben Qalliu. Konkretisht, pika 5, përcakton se: “5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit, leja e legalizimit, e shoqëruar nga dokumentacioni teknik, i dorëzohet ose i dërgohet në rrugë postare



subjektit përfitues”.

Sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se veprimtaria e z. Qalliu duke lejuar dorëzimin e dokumenteve nga nëpunësit e tij në ambiente familjare, dhe jo në sportelet e dedikuara ose nëpërmjet postës sikundër përcaktohet në vendimin 954/2015, të Këshillit të Ministrave, është “diskrecion” në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Sipas nenit 3, paragrafi 3 të KPA “Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.

Gjithashtu, Neni 11, Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parashikon se:

“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) është i parashikuar me ligj;

b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;

c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;

c) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.

Në kuptim të këtij parashikimi, z. Qalliu ka patur mundësinë të shfrytëzojë parashikimet e vendimit 954/2015, të Këshillit të Ministrave edhe të KPA për njoftimin dhe mënyrat e njoftimit në lidhje me dokumentacionin dhe respektimin e dispozitave të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, të cilat nuk i ka shfrytëzuar, por nën një diskrecion jo të ligjshëm ka lejuar dorëzimin e dokumenteve për të cilat vetë ai është përgjegjës jo në përputhje me ligjin.

Mënyra e ushtruar e këtij diskrecioni nga z. Qalliu ka kontribuar që dokumentet shtetërore të aksesohen dhe disponohen nga subjekte politike për t’u përdorur nga ana e tyre në kundërshtim me përcaktimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor.

Më tej, veprimet e kryera nga z. Qalliu bien ndesh edhe me parashikimet e neneve 155 dhe 156 të Kodit të Procedurave Administrative që parashikojnë si më poshtë:

Neni 155

Njoftimi nëpërmjet postës

1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur.



2. Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit.

3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet nëse marrësi provon se dokumenti nuk është marrë, apo është marrë në një ditë të mëvonshme.

Neni 156

Njoftimi nëpërmjet mjeteve elektronike

1. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi. Nëse njoftimi është i palexueshëm, marrësi mund t'i kërkojë organit publik ta ridërgojë njoftimin në një formë tjetër më të përshtatshme.

2. Një shkresë, dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e ligjit për komunikim elektronik.

3. Një shkresë e dërguar me faks vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e dërgimit.

4. Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen nëse marrësi provon se shkresa nuk është marrë, apo është marrë në një datë të mëvonshme.

Edhe në testin e parimit të proporcionalitetit, vendimmarrja e Drejtorit të ASHK Lushnjë për të ndaluar ofrimin e shërbimeve në sportele dhe mos marrja në konsideratë të përdorimit të mënyrave alternative zyrtare më të sigurta të parashikuara edhe në vendimin nr. 954/2015 të Këshillit të Ministrave, dorëzimi në sportelet e dedikuara ose me shërbimin postar, përbënin zgjedhjen më të përshtatshme me qëllim respektimin e dispozitave të nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ në krahasim me alternativën e përzgjedhur për të dërguar stafin të dorëzojë fizikisht certifikatat në shtëpitë e përfituesve të këtyre lejeve.

Fakti publik që një deputetet i një force politike administron dokumente të lëshuara nga ASHK Lushnjë, dëshmon se z. Arben Qalliu me veprimet e tij ka toleruar qasjen e subjekteve politike për të disponuar dokumente të cilat janë në përgjegjësinë e tij të drejtpërdrejtë dhe që duhej të ishin shpërndarë në sportel, shërbimet e ADISA ose me postë.

Ky instrument dëshmon se masat administrative të ndërmarra nga Drejtoria Vendore ASHK Lushnje, nuk shmang por inkurajon përdorimin dhe vënien e dokumenteve zyrtare në mbështetje të partive politike/ kandidatëve, shpërndarja e të cilave referuar nenit 3, pika 1.3, germa “a” dhe “b” përbëjnë veprimtari të ndaluara.



Me veprime te drejtpërdrejta z. Qalliu ka kontribuar indirekt që stafi në varësi të tij dhe dokumentet zyrtare të lëshuara për qytetarët, të vihen në dispozicion të subjekteve politike për të ushtruar aktivitetet të ndaluara në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 1.3 germa “a” dhe “b” të Vendimit të KQZ-së nr. 9 datë 24.12.2020.

Për më tepër, në rastin konkret edhe ligji nr. 111/2018 dhe ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nuk lejojnë/parashikojnë diskrecionin e ushtruar nga ana e z. Qalliu.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se veprimet e z. Arben Qalliu ka shkelur nenin 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe të Vendimin Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të nxjerrë në zbatim të tij.

Neni 10 i vendimit 9/2020 përcakton se “Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.” Për sa më sipër z. Arben Qalliu nuk është subjekt i kësaj dispozite.

Neni 171 pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se “Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë.”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n”, paragrafi 2, dhe nenet 91, 92, 171 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 3 paragrafi 2 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe nenet 17, 18, 19 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”

V E N D O S:

1. Të dënojë me gjobë z. Arben Qalliu, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore Lushnjë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në shumën **1,500 (njëmijë e pesëqind)** lekë për shkelje të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.
2. Ky vendin përbën titull ekzekutiv.



3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

